



Niveli Vendor në një Vështrim SHQIPËRIA

ROSKOVEC

Qershor 2020

Në shkurt të vitit 2018, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit si një marrëveshje trepalëshe midis Këshillit të Evropës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Roskovec. U caktua një pikë kontakti e bashkisë për programin ROMACTED nga Kryetarja e bashkisë për të ofruar mbështetje dhe për të lehtësuar procesin e zbatimit të programit në nivel bashkie.

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, në Roskovec u ngritën zyrtarisht Grupi Komunitar i Veprimit (GKV), Grupi Institucional i Punës (GIP) dhe Grupi i Task-Forcës së Bashkisë Roskovec (GTB).

Bashkia e Roskovecit ka qenë e ndjeshme ndaj nevojave të romëve dhe egjiptianëve vendorë, duke qenë një nga njësitë më miqësore të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri.

Kryebashkiakja Majlinda Bufi mori çmimin "Kryebashkiakja më Miqësore me Romët" në vitin 2019 nga Drejtorja e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Fajnjësinë dhe Negociatat për Zgjerim (DG Near).

Arritjet kryesore

DOKUMENTET VENDORE TË PËRGATITURA NË KUADRIN E ROMACTED

- Sondazhi për situatën bazë dhe kriteret përzgjedhëse të bashkisë;
- Vlerësimi i Kapaciteteve të Bashkisë - informacione të mbledhura për nevoja të administratës vendore për t'iu përgjigjur si duhet nevojave të komunitetit;
- Vlerësimi i Nevojave në Nivel Komuniteti - identifikimi dhe njohja e karakteristikave të komunitetit rom, nevojave, mundësive dhe kërkesave të tyre;
- Hartëzimi i Aktorëve të Interesuar - identifikimi i aktorëve të interesuar të të gjitha niveleve me qëllim krijimin e strukturave dhe sinergjive vendore;
- Hartimi i Listës së Prioriteteve të Komunitetit - janë identifikuar gjithashtu masat, mënyrat dhe aktorët, që kontribuojnë në arritjen e përmbushjes së nevojave kryesore;
- Hartimi i Planit Vendor të Veprimit - përkthimi i nevojave në aktivitete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të dakordësuara mes anëtarëve të Grupit të Task-Forcës së Bashkisë;
- Llogaritja e kostove të aktiviteteve të Planit Vendor të Veprimit - duke marrë parasysh afate të parashikuara, numrin e aktiviteteve dhe numrin e përfituesve, gjë që ndihmon autoritetet vendore në planifikimin e buxhetit dhe në buxhetimin afatmesëm;
- **Miratimi i Planit Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022** nga Këshilli Vendor i Bashkisë Përmet, me Vendimin nr. 47, **Egjiptiane 2019-2022** nga Këshilli Vendor i Bashkisë Përmet, me datë 17 maj 2019.

NGRITJA E KAPACITETEVE



Tre anëtarë të GTB-së u trajnuan për "Planifikimin Strategjik Vendor me Pjesëmarrje" gjatë 2018-tës, mbi "Zhvillimin e Planeve të Përbashkëta të Veprimit për Integrimin Rom në Nivel Vendor" gjatë 2019-tës dhe shtatë anëtarë të GTB-së u trajnuan mbi "Buxhetimin me Përgjigjshmëri Rome në Nivel Vendor" gjatë 2020-tës.

STREHIMI DHE INFRASTRUKTURA

Bazuar në nevojat e ngritura nga anëtarët e Grupit Komunitar të Veprimit, Bashkia ka zbatuar parimet e Buxhetimit të Përgjigjshëm Rom gjatë vitit 2019 përmes miratimit të këtyre projekteve, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në integrimin e romëve:

- Rehabilitimi i ujësjellësit të lagjes Liqeni i Kurjanit në shumën prej 30,000 lekësh;
- Rehabilitimi i rrugës në lagjen Liqeni i Kurjanit me një projekt me kosto 2,000,000 lekë;
- Instalimi i një transformatori për furnizimin me energji elektrike me kosto prej 1,500,000 lekë;
- U caktua një shumë prej 50,000 lekësh për aktivitete sociale në buxhetin vjetor të vitit 2019;
- U rikonstruktuan tre apartamente të familjeve rome nga Bashkia Roskovec me një projekt me kosto 1,500,000 lekë.



PUNËSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL



Që prej fillimit të zbatimit të Programit ROMACTED, janë punësuar 23 romë në fusha të ndryshme, si në institucione publike dhe private, në punë të përkohshme, vetëpunësim dhe biznese private:

- Katër janë punësuar në Bashkinë Roskovec si ndërmjetësues të komunitetit në Qendrën Sociale dhe Rinore; një person është punësuar si mësues i gjuhës rome në shkollën publike "Ajet Toska" në fshatin Suk 2; një si këshilltar në Këshillin Bashkiak në mbështetje dhe inkurajim të të gjithë këshilltarëve për miratimin dhe zbatimin e projekteve prioritare për romët; dhe një person është punësuar në ndërmarrjen e ujësjellës kanalizimeve të Roskovecit;
- Dy persona janë punësuar në një biznes rrobaqepësie;
- Një shofer është punësuar në kompaninë Trans Adriatic Pipeline (TAP);
- Tetë vetë janë punësuar në punë të përkohshme në mbledhjen e ullinjve në fshatin Kurjan;
- Një person është vetëpunësuar si berber; një në ndërtim; dhe një tjetër si bojaxhi i vetëpunësuar. Tre prej tyre kanë marrë mjete dhe pajisje nga ROMACTED. Kjo mbështetje është ofruar në kuadrin e nismës komunitare vendore nga Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) si një organizatë mbështetëse;
- Është krijuar një rrjet grash rome dhe jorome për shkëmbim përvojash dhe mundësish për punë dhe formim profesional.

ARSIMI DHE DIALOGU NDËRKULTUROR




- 42 fëmijë romë dhe egjiptianë janë shkollën fillore "Alush Grepcka" dhe në shkollën e mesme "Adem Vrapit";
- 23 nxënës romë janë ndihmuar për marrjen e teksteve shkollore falas në bazë të vendimit të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë;
- Është miratuar një listë emrash për transportin në shkollë të fëmijëve të komunitetit rom nga Kurjani për një vit me një buxhet prej 84000 lekësh nga Këshilli i Bashkisë Roskovec për vitin 2020;
- GKV-ja mori nismën e fillimit të mësimdhënies për të rritur, si dhe klasa mësimore shkrimi dhe leximi dhe klasa të gjuhës angleze për nxënësit falas në qendrën e komunitetit. Këto kurse organizohen dy herë në javë;
- Të kënduarit e himnit rom në shkolla të ndryshme për festimin e kulturës rome si pjesë e Ditës Ndërkombëtare Rome;
- Anëtarët e GKV-së morën nismën e llyerjes së kopshtit të bashkisë Roskovec si pjesë e nismës vendore të komunitetit me mbështetjen e ROMACTED;
- Më 5 prill 2018, u performua pjesa "Ena e Drunjtë" nga Edmund Morris nga nxënësit romë me rastin e javës rome. Kjo u organizua edhe në kuadrin e veprimtarisë së prezantimit vendor, me qëllim nxitjen e rëndësisë së fuqizimit të komuniteteve rome dhe integritit të romëve në Bashkinë Roskovec. Në këtë aktivitet morën pjesë 120 anëtarë të komunitetit rom, përfaqësues të Bashkisë Roskovec dhe institucioneve vendore, nxënës shkollash, përfaqësues nga Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë dhe Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) si organizatë mbështetëse.
- Nga 3 deri në 7 prill 2020 u organizua një ekspozitë virtuale "Misto avilen me khereste /Mirë se vini në shtëpinë time" për të shënuar 8 prillin gjatë shpërthimit të pandemisë së COVID-19 me rastin e 49 vjetorit të Ditës Ndërkombëtare Rome më 8 prill. Artistë të rinj romë i transformuan shtëpitë e tyre në një galeri për të shfaqur punimet e tyre artistike individuale, duke reflektuar botën e tyre të brendshme shpirtërore dhe vlerat e tolerancës, solidaritetit dhe bashkëjetesës.

AKSESI NË SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Gjatë muajit tetor 2019, në kuadrin e tetorit rozë u zhvillua një fushatë e mirëorganizuar për kancerin e gjirit. Të gjitha gratë rome dhe jorome morën pjesë në seancat e ndërgjegjësimit të kësaj fushate.




REGJISTRIMI NË GJENDJEN CIVILE



U mbështetën dy fëmijë romë për t'u regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile.


MASAT NDAJ COVID-19

- U shpërndanë informacione gjatë shpërthimit të COVID-19 për komunitetet rome në gjuhën rome, angleze dhe shqipe;
- U hartuan lista të familjeve dhe të moshuarve romë në Roskovec, që kishin nevojë për mbështetje urgjente;
- Kryetares të Bashkisë dhe Grupit Institucional të Punës iu drejtua një kërkesë për nevojat urgjente të romëve në Roskovec me shpërthimin e pandemisë COVID-19;
- Ofrimi dhe shpërndarja e 30 paketave të ndihmës së emergjencës u bë në koordinim mes Bashkisë Roskovec dhe Programit ROMACTED në lagjet nr. 1 dhe 2 të Njësisë Administrative të Liqenit të Kurjanit.



Strukturat e Programit

GRUPII KOMUNITAR I VEPRIMIT (GVK)
GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP)
GRUPIT TË TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



GRUPIT KOMUNITAR TË VEPRIMIT (GVK)



Janë organizuar 13 takime të GKV-së deri në mars 2020 me pjesëmarrjen e 196 romëve (66 gra rome). Numri mesatar i anëtarëve të GKV-së ka qenë 17-18 romë (8 -9 gra rome). Çdo tre mujor janë zhvilluar të paktën dy takime të GKV-së.

GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP)



Janë zhvilluar pesë takime të GIP-së me 51 pjesëmarrës nga drejtoritë e bashkisë dhe nga agjencitë e dekoncentruara. Çdo tremujor është organizuar një takim i GIP-së. Këto takime janë organizuar nga prilli 2018 deri në mars 2020.

GRUPII I TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



Janë organizuar tetë takime të GIP-së me 202 pjesëmarrës joromë dhe pjesëmarrës nga drejtoritë e bashkisë dhe 141 pjesëmarrës romë gjatë periudhës prill 2018-mars 2020.

Dokumente Strategjike Vendore

Plani Vendor i Veprimit

Programi ROMACTED ka kontribuar në hartimin e Planit Social të Bashkisë Roskovec. Pas një procesi gjithëpërfshirës, ky plan është buxhetuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Roskovec me vendimin nr. 47, datë 17 maj 2019.

Puna për përgatitjen e Planit Social të Bashkisë Roskovec ishte shumë transparente dhe u zhvilluan nëntë takime me autoritetet vendore, GKV-në dhe anëtarët e komunitetit. Si për projektimin e këtij plani, ashtu edhe për zbatimin e tij është ndjekur një qasje me pjesëmarrje për ta bërë atë më të përgjegjshëm dhe më afër pakicave.

Për mbledhjen e të dhënave fillestare përmes teknikave me pjesëmarrjen e komunitetit janë zhvilluar disa procese për hartëzimin e nevojave dhe burimeve, intervista individuale dhe diskutime në grupe. Këto që të gjitha janë shoqëruar nga një sërë vizitash në terren, vëzhgime dhe takime në zonat dhe grupet e bashkisë me problemet më të mëdha social-ekonomike. Kështu, në periudhën shkurt-prill 2019, eksperti kombëtar dhe koordinatorët vendorë të Programit ROMACTED kanë vizituar vazhdimisht këto zona dhe kanë zbatuar një sërë mjeteve dhe teknikash për mbledhjen e të dhënave.

Plani ka gjashtë objektiva strategjike dhe secili prej tyre ka disa nënobjektiva specifike. Në total, ky plan ka 15 objektiva/projekte specifike që kanë për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Projekte

Të zhvilluara në kuadër dhe/ose financuar prej programit

- Rehabilitimi i ujësjellësit të lagjes Liqeni i Kurjanit në shumën prej 30,000 lekësh;
- Rehabilitimi i rrugës në lagjen Liqeni i Kurjanit me një projekt me kosto 2,000,000 lekë;
- Instalimi i një transformatori për furnizimin me energji elektrike me vlerë 1,500,000 lekë;
- Një listë aktiviteteve sociale të buxhetuara për vitin 2019 në shumën prej 50,000 lekësh;
- Janë rikonstruktuar tre apartamente për familjet romë në Bashkinë Roskovec me një projekt me kosto 1,500,000 lekë;
- Regjistrimi i fëmijëve romë në shumën prej 50,000 lekë;
- Rikonstruksioni i rrugës së liqenit të Kurjanit (me gjatësi 400m) për përmirësimin e aksesueshmërisë së banorëve romë në qendrën e Roskovecit, projekt i mbështetur nga skema e granteve të vogla të ROMACTED;
- Përmirësimi i fasadës së kopshtit të Roskovecit, një nismë e GKV-së zbatuar gjatë 3-4 shtatorit 2019 dhe mbështetur nga Programi ROMACTED;
- Ofrimi i mjeteve të punës tre profesionistëve të rinj romë (një berber, një bojaxhi dhe një punëtor ndërtimi) si pjesë e një nisme komunitare vendore mbështetur nga Programi ROMACTED;
- Me miratimin e Planit Social, Bashkia aplikoi dhe fitoi dy projekte: "Në kafenenë e gjyshit" me shumën 3,861,750 lekë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe "Qendra e Kujdesit ditë për personat me aftësi të kufizuara" në shumën prej 4,291,034.00 lekë financuar nga UN / aftësi të kufizuara" në shumën prej 4,291,034.00 lekë financuar nga UN /

Sinergjitë

E krijuara në nivel vendor

- Bashkëpunimi mes GKV-së, GIP-së dhe institucioneve të tjera si shkollat, qendrat shëndetësore dhe institucionet e qarkut (Zyra e Punës Fier);
- Bashkëpunimi dhe sinergjitë mes ROMACTED dhe projekteve të tjera të zbatuara në Bashkinë Roskovec;
- Bashkëpunimi mes projektit "Sapuni Organik Roskoveci" financuar nga Bashkimi Evropian në kuadrin e Programit ReLOaD.
- Bashkëpunimi me Zyrën e Integritimit Evropian në Roskovec dhe Programit Bashkitë për Evropën;
- Kryetarja e Bashkisë Roskovec mori çmimin "Kryetarja e Bashkisë më Miqësore me Romët" në vitin 2019 për integrimin e romëve në kuadrin e Projektit të Nismës së Përbashkët për Fuqizimin e Shoqërisë Civile Rome në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, zbatuar nga Rrjeti ERGO dhe Roma Active Albania. Ekipi mbështetës i ROMACTED ka qenë i përfshirë aktivisht në inkurajimin e aktorëve vendorë për aplikimin për këtë çmim.

Kontaktet

Kryetarja e Bashkisë Roskovec: Znj. Majlinda BUFI

Pika e Kontaktit në Bashki: Znj. Everina TAFA

Lehtësuesi e ROMACTED: Z. Sead KAZANXHIU

